



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/ Republic of Kosovo**  
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tuzilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 379/2023

Datë: 23 maj 2023

Këshilli Prokurorial i Kosovës, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj Ervehe Gashi, Prokurore në Prokurorinë Themelore në Prizren, në pajtim me nenin 34 të Ligjit Nr. 06/L - 056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 13 të Ligjit Nr. 06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, sipas Marrëveshjes vullnetare për shkeljen e supozuar disiplinore AD.nr.03/2023, të datës 28 prill 2023, gjatë shqyrtimit të mbajtur më datë 23 maj 2023, në seancën e këshillimit dhe votimit mori këtë:

**VENDIM**

- I. **MIRATOHET** marrëveshja vullnetare për shkeljen disiplinore me numër AD.nr.03/2023, të datës 28 prill 2023, e lidhur në mes Panelit Hetimor dhe subjektit të hetimit disiplinor Ervehe Gashi, Prokurore në Prokurorinë Themelore në Prizren.
- II. Prokurores Ervehe Gashi i shqiptohet sanksioni disiplinor "Vërejtje publike me shkrim" konform nenit 7, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.
- III. Marrëveshja vullnetare për shkeljen disiplinore dhe sanksionin disiplinor e miratuar nga Paneli Hetimor do të ketë të njëjtin efekt ligjor sikurse vendimi i Këshillit për shkelje disiplinore, konform nenit 13 të Ligjit Nr.06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Jetish Maloku

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'u dërgohet:

- Z. Admir Shala, Kryeprokuror i Prokurorisë Themelore në Prizren
- Znj. Ervehe Gashi, Prokurore në Prokurorinë Themelore në Prizren
- Arkivit të KPK-së